# SYLLABUS I LËNDËS “E DREJTA ROMAKE”

| **Të dhëna bazike të lëndës** | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | Fakulteti Juridik |
| **Titulli i lëndës:** | E drjeta romake |
| **Programi:** | Juridik i përgjithshëm |
| **Niveli:** | Bachelor |
| **Statusi lëndës:** | Obligative |
| **Viti i studimeve:** | Viti i I-rë, Semestri i II-të |
| **Numri i orëve në javë:** | 3+2 |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | 6 |
| **Koha / lokacioni:** | Fakulteti Juridik |
| **Mësimdhënësi i lëndës:** | Prof. Asoc. Dr. Kadri Kryeziu |
| **Të dhënat kontaktuese:** | kadri.kryeziu@uni-prizren.com |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës:** | E drejta romake si disiplinë mësimore studiohet në kontekstin historik të zhvillimit të shtetit romak, në sturkturën shoqërore dhe ekonomike si dhe referimit të burimeve juridike.<br>Meqenëse zbatimi praktik i saj ka përfunduar, e drejta romake ka fituar karakterin e disiplinës juridiko-historike me një përmbajtje afërsisht të unisuar në shumicën e fakulteteve juridike të universiteteve evropiane. Bërthamën e lëndës e përbëjnë institucionet e Justinianit duke prezentuar të drejtën private romake në kuptimin e saj të gjerë përfshin të drejtën, të drejtën statusore dhe të drejtën familjare.<br>Përmes kësaj lënde synohet që të kuptohen parimet dhe mekanizmat e së drejtës romake. Studimi i saj përqendrohet në krijimin e koncepteve kryesore të së drejtës civile, zhvillimin e mendimit juridik, rrethanat në të cilat janë krijuar institutet e të drejtës romake, zhvillimin e tyre dhe mjeteve përmes të cilave e drejta është zbatuar në jetën e përditshme.<br>Në këtë drejtim, kjo disiplinë ndër të tjera shërben për mësimin e të drejtës civile bashkëkohore. |
| | |
| **Qëllimi i lëndës:** | Kjo lëndë ka për qëllim gjenerimin e njohurive lidhur me procesin e krijimit, evoluimit dhe ndryshimeve në institucionet dhe normat e së drejtës romake nën veprimin e rrethanave të ndryshme historike, kuptimi i vazhdueshmërisë së traditës juridike të Evropës kontinentale dhe teorisë juridike; nxjerrja e përfundimeve të përgjithshme lidhur me rolin dhe ndikimin e së drejtës në zhvillimin historik të shtetit romak; njohja me ndikimin e së drejtës romake në të drejtën bashkëkohore të shteteve evropiane e cila është ndërtuar mbi konceptet dhe normat e së drejtës romake, njohja me teknikat e punës së juristëve romak të cilat paraqesin model me vlera të përhershme kur është fjala për funksionimin praktik të së drejtës dhe përshtatjes së saj nevojave shoqërore. |
| | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit**: | Pas përfundimit të suksesshëm të ligjëratave studentët duhet të jenë në gjendje të:<br><br>• kuptojnë rolin dhe ndikimin e së drejtës romake në zhvillimin historik të shtetit romak;<br>• kuptojnë dhe të përshkruani parimet themelore, institutet juridike dhe rregullat e punës së juristëve romak.<br>• mësojnë terminologjinë juridike e cila edhe sot është aktuale;<br>• kuptojnë ndikimin e së drejtës romake në të drejtën bashkëkohore të shteteve evropiane;<br>• mësojnë teknikat e punës së juristëve romak të cilat paraqesin model me vlera të përhershme kur është fjala për funksionimin praktik të së drejtës dhe përshtatjes së saj me nevojat shoqërore. | | |
| **Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)** | | | |
| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithsej** |
| Ligjërata | 3 | 15 | 45 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 2 | 15 | 30 |
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 1 | ¼ | 4 |
| Ushtrime në terren | | | |
| Kollokfiume, seminare | 1 | 1/1 | 1 |
| Detyra të shtëpisë | 1 | 1/1 | 1 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 3 | 15 | 45 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 2 | 1/10 | 20 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final) | 1 | ½ | 2 |
| Projektet, prezantimet ,etj | 1 | ½ | 2 |
| **Totali** | | | **150 orë (6 ECTS)** |
| **Metodologjia e mësimdhënies:** | Metodologjia e mësimdhënies do të konsistojë në ligjërimin e lëndës sipas metodës interaktive . Me qëllim të përgatitjes sa më të mirë të lëndës dhe të mundësisë për ndërveprim më të madh në klasë, rekomadohet që studentët të lexojnë paraprakisht materialet për temën e cila do të diskutohet në orën pasuese. Studentët inkurajohen të parashtrojnë pyetje, | | |

| | |
|---|---|
| | komente dhe sugjerime gjatë ligjëratave si dhe të ngrisin edhe diskutime që kanë relevancë me temën e ligjëratës. |
| **Metodologjia e vlerësimit:** | **Vlerësimi me gojë dhe me shkrim:**<br>Pjesëmarrja dhe aktiviteti në ligjërata………5%<br>Pjesëmarrja dhe aktiviteti në ushtrime ……...5%<br>Punime seminarike .... ……………..…......10%<br>Vlerësimi final: ………………………..80%<br>_______________________________________<br>Totali: …………………………………100% |
| **Literatura** | |
| **Literatura primare:** | 1. Kadri Kryeziu, *"E drejta romaket*", Prizren, 2017.<br>2. Asllan Bilalli & Bedri Bahtiri, "E Drejta Romake", Prishtinë, 2015.<br>3. Arta Mando, "E Drejta Romake", Tiranë, 2011. |
| **Literatura shtesë:** | 1. Borkowski & DuPlesis, "E Drejta Romake", (Perkthyer nga Guri Daco), Tirane 2000.<br>2. Barry Nicholas, "An Introduction to Roman Law", Oxford, 1975.<br>3. Andrew Borkowski & Paul du Plessis, "Textbook on Roman Law", Oxford, 2005.<br>4. Arta Mandro, "E drejta romake", Tiranë, 1998. |

| **Plani i dizajnuar i mësimit:** | | |
|---|---|---|
| **Java** | **Ligjërata** | **Ushtrime** |
| *Java e parë:* | Prezentim i programit të lëndës dhe metodologjisë së mësimdhënies | Prezentim i metodologjisë së mësimdhënies gjatë ushtrimeve |
| *Java e dytë:* | Vështrim i përgjithshëm i shtetit dhe të drejtës romake<br>Burimet e të drejtës romake<br>Emërtimi i së drejtës romake<br>Rëndësia dhe ndikimi i së drejtës romake<br>Periodizimi i së drejtës romake | Pyetje për diskutim, perseritje |
| *Java e tretë:* | Periudha e lashtë e Mbretërisë Romane<br>Periudha e dytë e zhvillimit historik të shtetit dhe të së drejtës romake<br>Periudha e tretë e të drejtës romake-perandoria imperia | Përsëritje |
| *Java e katërt:* | E drejta personale (Jus quod ad personas pertinent)<br>E drejta statustore | Perseritje-E drejta personale |

| | | |
|---|---|---|
| | Subjektet e së drejtës<br>Zotësia juridike dhe e veprimit e personave fizik | |
| *Java e pestë:* | E drejta familjare<br>Familja romake, pozita juridike e anëtarëve të familjes.<br>E drejta martesore<br>Kushtet për lidhjen e martesës<br>Pengesat për lidhjen e martesës, fejesa, Format për lidhjen e martesës, marrëdhëniet personale dhe pronësore mes bashkëshortëve<br>Zgjidhja e martesës<br>Tutoria dhe kujdestaria<br>Llojet e tutorisë dhe kujdestarisë | Përsëritje-E drejta familjare |
| *Java e gjashtë*: | Marrëdhëniet juridike reale (Jus qoud as res pertinent)<br>Marrëdhëniet juridike reale<br>Nocioni mbi sendet<br>Llojet e sendeve<br>Krijimi i të drejtës në pronën private<br>Kuptimi i pronës private<br>Kufizimet e të drejtave të pronarëve privat | Përsëritje-Marrëdhëniet juridike dhe prezentim i punimeve |
| *Java e shtatë:* | Mënyrat e fitimit të pronës<br>Mbrojtja dhe humbja e të drejtës pronësore<br>Posedimi<br>Të drejtat reale mbi sendet e huaja | Përsëritje-Mënyrat e fitimit të pronës dhe prezentim i punimeve |
| *Java e tetë:* | E drejta detyrimeve dhe marrëdhëniet e detyrimeve<br>Kuptimi i marrëdhënieve të detyrimeve<br>Subjektet e marrëdhënieve të detyrimeve<br>Përmbajtja e marrëdhënieve të detyrimeve | Përsëritje-E drejta e detyrimeve dhe marrëdhëniet e detyrimeve |
| *Java e nëntë:* | Burimet e detyrimeve<br>Kontrata si burim I detyrimeve<br>Elementet e kontratave të detyrimeve<br>Kontratat formale të së drejtës së lashtë romake<br>Kontratat verbale | Përsëritje-Burimet e detyrimeve dhe prezentim i punimeve nga studentët |

| | | |
|---|---|---|
| | Kontratat reale<br>Kontratat literale<br>Kontratat konsensuale | |
| *Java e dhjetë:* | Deliktet si burim detyrimesh<br>Kuptimi dhe krijimi i delikteve private<br>Elementet e delikteve private<br>Ndarja e delikteve private<br>Shuarja e detyrimeve<br>Vonesa e kreditorit dhe debitorit | Përsëritje-deliktet si burim detyrimesh dhe prezentim i punimeve të studentëve |
| *Java e njëmbëdhjetë:* | Marrëdhëniet trashëgimore juridike<br>Suksesidimi morti causa dhe inter vivos<br>Objekti i trashëgimisë<br>Kushtet për suksesim trashëgimor<br>Llojet e trashëgimtarëve | Përsëritje-Marrëdhëniet trashëgimore juridike dhe prezentim i punimeve të studentëve |
| *Java e dymbëdhjetë:* | Testamenti<br>Format e testamentit<br>Revokimi dhe pavlefshmëria e testamentit<br>Suksedimi singular<br>Dhurata në rast vdekje | Përsëritje-Testamenti dhe prezentim i punimeve të studentëve |
| *Java e trembëdhjetë:* | Procedura civile<br>Ndarja e procedurës civile<br>Zhdukja e vetëmbrojtjes<br>Organet e procedurës legjislatore<br>Procedura formulare | Përsëritje-Procedura civile dhe prezentim i punimeve të studentëve |
| *Java e katërmbëdhjetë:* | Mjetet e jashtëzakonshme për mbrojtjen e të drejtave subjektive | Përsëritje-Mjetet e jashtëzakonshme për mbrojtjene të drejtave subjektive dhe prezentim i punimeve të studentëve |
| *Java e pesëmbëdhjetë:* | Parapërgaditje për provim | Parapregaditje për provim |

**Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

***Studentët janë të obliguar :***

- Studenti duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe njëkohësisht të jetë i vëmendshëm në orën mësimore.
- Plagjiatura dhe fenomenet e ngjashme mashtruese do të ndëshkohen sipas akteve juridike në fuqi.
- Të respektohet Kodi i Etikës për Studentë i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren.